



http://www.sony.net/

© 2012 Sony Corporation



PARALAJMËRIM

Për të reduktuar rrezikun e zjarrit ose goditjeve elektrike, kjo aparaturë nuk duhet të ekspozohet ndaj shiut ose lagështirës.

Për të zvogëluar rrezikun e zjarrit, mos e mbuloni hapësirën e ajrimit të pajisjes me gazeta, mbulesa tavoline, perde etj.

Mos e ekspozoni pajisjen ndaj burimeve me flakë të pambrojtur (për shembull, qirinjtë e ndezur).

Për të reduktuar rrezikun e zjarrit ose goditjeve elektrike, kjo pajisje nuk duhet të ekspozohet ndaj pikimeve ose spërkatjeve me ujë dhe mbi pajisje nuk duhen vendosur objekte të mbushura me lëng, siç janë vazot.

Për të shmangur goditjen elektrike, mos e hapni kabinetin. Për shërbimet drejtojuni vetëm personelit të kualifikuar.

Mos e instaloni pajisjen në një hapësirë të kufizuar, si në një raft librash ose në një mobilie inkaso. Instalojeni këtë sistem në mënyrë të tillë që kordonin i energjisë të mund të hiqet menjëherë nga priza në rast problemi.

Për klientët në Evropë





Hedhja e pajisjeve të vjetra elektrike dhe elektronike (e aplikueshme në Bashkimin Evropian dhe vendet e tjera evropiane me sistem grumbullimi të diferencuar)

Ky simbol mbi produkt ose mbi paketimin e tij tregon se ky produkt nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake. Përkundrazi, do të dorëzohet pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike. Duke u siguruar që ky produkt të hidhet siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin, që në rast të kundërt do të shkaktoheshin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të këtij produkti. Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore. Për më shumë informacion të detajuar mbi riciklimin e këtij produkti, ju lutemi kontaktoni me bashkinë tuaj, shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin.

Njoftim për klientët: Informacioni i mëposhtëm aplikohet vetëm për pajisjet e shitura në vendet ku aplikohen Direktivat e BE-së.

Ky produkt është prodhuar nga ose për llogari të Sony Corporation, 1-7-1 Konan Minato-ku Tokyo, 108-0075 Japoni. Pyetjet në lidhje me pajtueshmërinë e produktit sipas legjislacionit të Bashkimit Evropian do t'i adresohen përfaqësuesit të autorizuar, Sony Deutschland GmbH, Hedelfinger Strasse 61, 70327 Stuttgart, Gjermani. Për çdo çështje shërbimi ose garancie, drejtojuni adresave që jepen në dokumentet e posaçme të shërbimit ose të garancisë.



Kur ndizni ose fikni një amplifikator ose pajisje tjetër
Uleni volumnin e amplifikatorit në minimum.

Për të shmangur dëmtimin e nën-vuferit

- Kini kujdes në vendosjen e kontrollit të volumnit të amplifikatorit për të shmangur fuqinë e lartë hyrëse.
- Mos u përpiqni të hapni pajisjen ose të hiqni njësitë e altoparlantëve dhe rrjetet.
- Mos e shtypni mbrojtësen e pluhurit, qoftë me dashje ose pa dashje.

Nëse vërehen parregullsi ngjyrash në ekranin e televizorit aty pranë

Me llojin e mbrojtjes magnetike të sistemit të altoparlantëve, nën-vuferi mund të instalohet pranë një televizori. Megjithatë, mund të vërehen sërish parregullsi ngjyrash në ekranin e televizorit në varësi të llojit të televizorit.

Nëse vërehet parregullsi ngjyrash...


→Fikni një herë aparatin e televizorit, më pas ndizeni pas 15 deri 30 minutash.

Nëse vazhdojnë të vërehen parregullsi të ngjyrave...



→Vendoseni nën-vuferin më larg nga aparati juaj i televizorit.

Kur ka zhurma piskatëse

Ndryshojni vendin altoparlantit ose ulni volumnin e amplifikatorit.



↔: Drejtimi i sinjalit




Mbi pastrimin e kasës së pajisjes

Pastroni kasën e pajisjes me një copë të butë të njomur lehtë. Mos përdorni asnjë lloj pastruesi abraziv, tela fërkimi ose tretës si alkooli ose benzina.



Nëse keni pyetje ose probleme në lidhje me nën-vuferin që nuk përfshihet në këtë manual, ju lutemi kontaktoni shitësin më të afërt të Sony.

Instalimi

Duke qenë se veshi i njeriut nuk arrin të dallojë drejtimin dhe pozicionin ku riprodhohet tingulli bas nga nën-vuferi, (nën 200 Hz) ju mund të instaloni nën-vuferin në çdo vend që dëshironi në dhomë. Për të arritur një riprodhim më të mirë të basit, rekomandojmë të instaloni nën-vuferin në një dyshme të qëndrueshme ku nuk ka të ngjarë të ndodhë rezonancë. Ju mund të merrni riprodhim të mjaftueshëm të basit të rëndë nga një nën-vufer i vetëm. Megjithatë, nëse përdorni më shumë se një nën-vufer mund të arrini një riprodhim edhe më efikas të basit të rëndë.



↔: Drejtimi i sinjalit



Shënime

- Gjithmonë instalojeni nën-vuferin vertikalisht duke ruajtur distancë disa centimetra larg murit.
- Mos vendosni objekte mbi nën-vufer ose mos u ulni mbi të.
- Nëse nën-vuferi instalohet në qendër të një dhome, basi mund të jetë jashtëzakonisht i dobët. Kjo ndodh për shkak të influencës së valës mbetëse të dhomës. Nëse ndodh kjo, lëvizeni nën-vuferin larg qendrës së dhomës ose eliminoni shkakun e valës mbetëse duke vendosur një raft librash në mur, etj.

Montimi i sistemit

Pamje e përgjithshme


Përdorni foletë LINE IN ose terminalet SPEAKER IN të nën-vuferit kur lidhni amplifikatorin **(A)**.

- Nëse amplifikatori ka një nga llojet e mëposhtme të foleve dalëse, lidhni folenë LINE IN dhe folenë e amplifikatorit duke përdorur kordonin e dhënë të lidhjes audio.
 - Foleja MONO OUT
 - Foleja MIX OUT
 - Foleja/foletë dalëse SUBWOOFER
 - Foleja/foletë dalëse SUPER WOOFER



- Nëse amplifikatori nuk ka llojet e poshtëpërmendura të foleve dalëse, lidhni terminalet e altoparlantit të amplifikatorit me terminalet SPEAKER IN.

Përpara se të filloni


- Fikni amplifikatorin dhe nën-vuferin përpara se të bëni ndonjë lidhje.
- Përdorni në pajisjen përkatëse kordonët e lidhjes audio që keni marrë. Nëse nuk ka kordonë të mjaftueshëm për lidhjen audio për të kryer lidhjet e nevojshme, duhet të blini kordonë opsionalë për lidhje audio.
- Sigurohuni që t'i bëni lidhjet të forta për të shmangur zhurmën.
- Lidhni kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë nga nën-vuferi në një prizë muri.
- Ju nuk mund të lidhni me nën-vuferin folenë dalëse CENTER që përdoret për funksionin Dolby Pro Logic. Tingulli bas nuk del në disa modalitete të Dolby Pro Logic.



↔: Drejtimi i sinjalit




- Lidhni nën-vuferin me amplifikatorin. **(B)**
Lidhni terminalet SPEAKER IN të nën-vuferit me terminalet e altoparlantit të amplifikatorit duke përdorur kordonët e altoparlantit. Sigurohuni që të lidhni si kanalin L ashtu edhe R.
- Lidhni altoparlantët e përparmë me nën-vuferin. **(C)**
Lidhni altoparlantët me terminalet SPEAKER OUT të nën-vuferit.





- Lidhni altoparlantët e përparmë me amplifikatorin. **(D)**
Lidhni altoparlantët me terminalet SPEAKER A të amplifikatorit.
- Lidhni nën-vuferin me amplifikatorin. **(E)**
Lidhni terminalet SPEAKER IN të nën-vuferit me terminalet SPEAKER B të amplifikatorit duke përdorur kordonët e altoparlantit (nuk jepen).

Kur përdorni sete të dyfishta altoparlantësh (A + B), sigurohuni që të zgjidhni pozicionin "A + B" në amplifikator.



↔: Drejtimi i sinjalit



Shënimi

Kur përdorni vetëm terminalet SPEAKER A (vetëm altoparlantin e përparmë) ose kur fiket amplifikatori, ulini volumnin nën-vuferit ose fikeni, mund të dëgjohet një zhurmë gumëzhitëse.

Lidhja me një amplifikator me një fole të veçantë për një nën-vufer

Nëse amplifikatori ka një fole të veçantë për nën-vufer (si p.sh. fole MONO OUT, fole MIX OUT, fole SUBWOOFER ose fole SUPER WOOFER), lidhni folenë LINE IN të nën-vuferit me një nga ato fole duke përdorur kordonin e dhënë të lidhjes audio. **(F)**

Montimi

Lidhni terminalet MONO OUT të amplifikatorit me folenë LINE IN të nën-vuferit duke përdorur kordonin e dhënë të lidhjes audio. **(G)**

Shënimi

Nëse niveli i daljes i amplifikatorit nuk është shumë i madh, tingulli mund të mos jetë shumë i lartë. Në këtë rast, lidhni terminalet e altoparlantit të amplifikatorit direkt me terminalet SPEAKER IN të nën-vuferit.

